



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site:www.klsh.org.al

Nr. 777/ 9 Prot.

Tiranë, më, 15/12/2017

V E N D I M

Nr. 172, Datë 15/12/2017

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN PREFEKTI I QARKUT DURRËS
"MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË"**

(Për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datën 30.06.2017)

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë i kryer në subjektin Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm (MFK), mosnjohje dhe mos implementim si duhet i kërkesave të MFK, për arsye të mos rregjistrimit në kontabilitet të sipërfaqes së truallit shtetëror 728 m² dhe sipërfaqes së ndërtesës së zyrave 357 m², pasqyrat financiare nuk paraqesin drejt dhe në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të llogarisë së aktiveve të institucionit, devijime në fushën e zbatimit të ligjshmërisë për vlerësimin e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë", të ushtruar në Institucionin Prefekti i Qarkut Durrës, sipas programit të

auditimit nr.777/1 prot., datë 17.07.2017, për veprimtarinë nga data 01.01.2013 deri më 30.06.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A.MASA ORGANIZATIVE

1-Gjetje nga auditimi: Në tre raste në vitin 2013, për të cilat nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë është marrë vendim për rikonfirmim të vlefshmërisë ligjore të aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) u konstatua se, në dosjet përkatëse të këtyre vendimeve ka mungesë të dokumenteve të rëndësishme, si çertifikata e gjendjes familjare më datën 01.08.1991, vërtetimi nëse qytetari ka qenë më datën 01.08.1991 anëtar i ish kooperativës bujqësore, vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore etj., të cilat në shkresën e vendimit cilësohen se janë marrë në analizë nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, por në fakt nuk janë pjesë e dosjes. Gjithashtu në shqyrtimin e këtyre vendimeve Komisioni nuk ka marrë në analizë të gjitha AMTP që disponon qytetari. Këto mangësi nuk japin siguri se këto vendimet janë të drejta e në përputhje me kërkesat ligjore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me seksionin I, pika 2, të udhëzimit të KM nr.2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga KV, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”. Konkretisht vendimet: nr.270 datë 21.03.2013 “Për rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 240/1, datë 20.07.2003”, në emër të qytetarit **R. H.**; vendimi nr.271, datë 21.03.2013 “Për rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr.101/1 datë 25.10.2003”, në emër të qytetarit **H. Zh.**, vendimi nr.273, datë 21.03.2013, “Shfuqizim i pjesshëm i AMTP nr. 64/1, datë 10.02.2002, të familjes bujqësore të përfaqësuar nga qytetari **M. C**”.

1.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pasi të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, të rishqyrtoj 3 vendimet e KVVTP respektivisht: nr.270 datë 21.03.2013, nr.271, datë 21.03.2013 dhe nr. 273, datë 21.03.2013.

Menjëherë

2-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes në të cilën është marrë vendimi nr. 275, datë 21.03.2013, për “Shfuqizim të pjesshëm të AMTP nr. 165, datë 02.10.1995”, në emër të z. **R.Xh.** nga Komisioni Vendor nuk është shfuqizuar sipërfaqja 500 m², zë kadastral truall e cila nuk duhet të jetë pjesë e AMTP së mësipërme, pasi më datën 01.08.1991 nuk figuron në regjistrat kadastralë në zërin “Tokë bujqësore”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: nenin 2, pika 1, germa a, nenin 3, pika 2, germa b, nenin 9, pika 1, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”, seksionin 2, pika C, germa (c) dhe (i).

2.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të rishqyrtojë vendimin nr. 275, datë 21.03.2013, në lidhje me AMTP nr. 165, datë 02.10.1995, duke kërkuar pavlefshmëri të pjesshme për sipërfaqen 500 m², zë kadastral truall, pasi akti i marrjes së tokës në pronësi nuk ka vlefshmëri ligjore për sipërfaqet e tokave të cilat në datën 01.08.1991, nuk përfshihen në zërin kadastral “Tokë bujqësore”.

Menjëherë

3-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, për shqyrtimin e ankesës datë 20.01.2017 të qytetares **M.J.**, e cila ka konflikt pronësie me z. **Z. V.P.**, nuk ka kryer hetim të plotë administrativ, duke mos kërkuar nga institucionet përkatëse (ZRPP etj),

dokumentacionin e duhur për znj. **M.J.**, por vetëm për z. **Z.P.**, veprime me dy standarde. Në këtë mënyrë hetimi administrativ është kryer vetëm për njërin nga dy qytetarët në konflikt pronësie dhe si rezultat, gjykimi përfundimtar i Komisionit Vendor për pamundësinë e shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të 2 akteve të marrjes së tokës në pronësi, në emër të z. **Z.P.** (për të cilin **M.J.** pretendon se nëpërmjet tyre i ka marrë padrejtësisht tokën bujqësore), nuk jep siguri se është i drejtë e në përputhje me kuadrin ligjor. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, udhëzimin nr.2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”.

3.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, të kryej hetim të plotë administrativ në përgjigje të ankesës së qytetares **M.J.**, duke marrë në shqyrtim dokumentacionin e plotë të të dy palëve në konflikt për tokën bujqësore.

Menjëherë

4-Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë, për shqyrtimin e ankesës së qytetarit **A. S.**, datë 11.6.2014, Manëz Durrës, për verifikimin e AMTP nr. 245, 245/1 dhe 245/2, nuk ka kryer hetim të plotë administrativ, pasi nuk ka marrë në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke mos kërkuar nga ISSH, ZRPP, SAMT Qarkut Durrës, dokumentet përkatëse ligjore. Në këto kushte vendimi nr. 21, datë 05.11.2015, i Komisionit “Për pamundësinë e përfundimit të hetimit administrativ”, nuk jep siguri se është vendim i drejtë, nuk ka zgjidhur konfliktin brenda familjes **S.** dhe është marrë në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”.

4.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pasi të ketë siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, të rishqyrtoj kërkesën e z. **A.S.** dhe vendimin e KVVTP nr. 21, datë 05.11.2015.

Menjëherë

5-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në shqyrtimin e ankesës nr. 1238, datë 18.05.2015 të vëllezërve **Sh.** me objekt “Kërkesë për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 280, datë 10.7.2006, në emër të z. **B.B.**”, nuk ka bërë hetim të plotë administrativ, duke mos marrë në konsideratë të gjitha faktet.

Komisioni ka marrë vendimin nr. 22, datë 5.11.2015, për “Pamundësinë e marrjes në shqyrtim të AMTP nr. 280, datë 10.7.2006, por pas daljes së fakteve të reja nga Drejtoria e Policisë Durrës me shkresën nr. 99, datë 06.01.2016, se AMTP e mësipërme disponohet në ZVRPP Durrës në origjinal, Komisioni nuk ka marrë në rishqyrtim vendimin e tij nr. 22, datë 5.11.2015, duke mos zgjidhur konfliktin midis familjeve të vëllezërve **Sh.** dhe z. **B.B.** Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, udhëzimin nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”.

5.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, të rishqyrtoj vendimin nr. 22, datë 5.11.2015 dhe të vlerësoj vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 280, datë 10.7.2006. Për këtë të bëjë hetim të ri administrativ lidhur me kërkesën nr. 1238, datë 18.05.2015 të vëllezërve **Sh.**, duke rikërkuar nga institucionet shtetërore dhe ankimesi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Menjëherë

6-Gjetje nga auditimi: Në një rast, në marrjen e vendimit nr.30, datë 30.12.2016, për rikonfirmim të vlefshmërinë ligjore të AMTP nr.58, datë 23.07.1992, me sipërfaqe toke 15,000 m², në emër të z.**Sh.F**, Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, ka marrë vendim duke mos u mbështetur në dokumente origjinale, pasi AMTP-ja e mësipërme është fotokopje e pa noterizuar dhe me korrigjim tek parcela 190/36 me sipërfaqe 2,700 m², pasi është pasqyruar në një kohë të dytë (në vitin 1994) dhe nuk ekziston në dokumentacionin e DAMT Durrës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e KM nr.2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”.

6.1-Rekomandimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pasi të ketë siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, të rishqyrtoj vendimin e datës 30.12.2016, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr.58 datë 23.07.1992.

Menjëherë

7-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për një kohëzgjatje mbi 2 vjet, nuk ka marrë vendim për shqyrtimin e ankesës së z. **G.P** datë, 04.06.2015, mbi vlefshmërinë ligjore të AMTP nr.7, datë 12.09.1991 me sipërfaqe 7500 m² tokë dhe AMTP nr. 8, datë 28.12.2006 në të cilën i është hequr sipërfaqja 2,640 m² dhe i është dhënë tjetër qytetari, ndërsa vet z. **G.P** është kompensuar me tokë në një parcelë tjetër, shkak i cili e ka detyruar të mos e nënshkruaj AMTP nr. 8 datë 28.12.2006.

Komisioni nuk ka analizuar me themel vlefshmërinë ligjore të AMT nr. 7 datë 12.09.1991, shkaqet e ndryshimeve të sipërfaqes së tokës në të, nëse AMTP-ja nr. 8, datë 28.12.2006, është krijuar mbi bazën e korrigjimeve të AMTP nr.7 dhe sa ligjore janë këto ndryshime, duke mos zgjidhur konfliktin për tokën bujqësore midis dy familjeve.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 7, pika 2, germën a, nenin 8 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, udhëzimin nr.2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore, nga KVVTP, kur këtë e kërkojnë individë ose institucione”, me nenin 7, pika 2, germën a, nenin 8 pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar.

7.1-Rekomandimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, mbi bazën e të cilit të marrë në shqyrtim ankesën e z.**G.P**. për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr.7, datë 12.09.1991, duke verifikuar ligjshmërinë e ndryshimit të sipërfaqes prej 2,640 m² në të, nëse AMTP nr.8 datë 28.12.2006, është krijuar mbi bazën e korrigjimit të AMTP nr.7 dhe nëse ky ndryshim është ligjorë, Gjithashtu në interes të zgjidhjes së konfliktit midis palëve duhet të kryej hetim administrativ edhe për vlefshmërinë e AMTP së cilës i ka kaluar sipërfaqja 2,640 m² hequr, nga AMTP nr.7, datë 12.09.1991.

Menjëherë

8-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nuk ka hartuar regjistër për dokumentimin e kërkesave që vijnë nga individë apo institucione për verifikimin e titujve të pronësisë, duke mos pasur një bazë të dhënash të saktë për numrin e kërkesave të ardhura të shqyrtuara e të pa shqyrtuara. Për vitin 2013 kërkesat e ardhura janë mbajtur në libër protokoll nga vetë komisioni, i cili nuk administrohet aktualisht nga institucioni, duke mos u regjistruar në protokollin kryesor.

Për vitin 2014-2017, pas regjistrimit në protokoll dosja (kërkesa) nuk është shoqëruar brenda ditës me kartelë shoqëruese, si dhe nga drejtori i KV nuk është caktuar brenda ditës relatori i çështjes që do të trajtojnë kërkesën. Për 168 raste për të cilat KVVTP është shprehur me vendim, në asnjë rast hetimi administrativ nuk ka përfunduar brenda afatit 3 mujor për të gjithë periudhën 2013-2017, duke dështuar kthimi i përgjigjeve në afat ndaj subjekteve të interesuara, në kundërshtim me nenin nr.2, nr.7, nr.8, nr.9 dhe nr.12, 14 të vendimit nr.1, datë 27.03.2009 të Komisionit Qeveritar të Tokës, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë”.

8.1-Rekomandim: 1-Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nën mbikëqyrjen e Prefektit të Qarkut Durrës, të kryej regjistrimin e të gjitha kërkesave të ardhura për shqyrtim për periudhën 2013-2017, me të gjitha të dhënat e nevojshme, prej tyre të identifikojë kërkesat e shqyrtuara dhe ato ende të pa shqyrtuara, për të cilat të marrë masa të menjëhershme për shqyrtim.

2-Dosjet e përfunduara të inventarizohen duke listuar të gjitha dokumentacionin që përmbajnë e të dorëzohen në arshivën e institucionit. Për çdo kërkesë të ardhur, menjëherë të behet inventari i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës. Drejtori i KVVTP ti dorëzojë relatorit të çështjes dosjen për shqyrtim kundrejt nënshkrimit të dy palëve për inventarin e dosjes. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes kundrejt këtij inventari të bëhet dorëzimi i dosjes në arshivë nga drejtori dhe relatori i çështjes. Drejtori i KV të krijojë bazën e vet të të dhënave për të gjitha kërkesat e ardhura e procesin e trajtimit të mëtejshëm të tyre.

Menjëherë

9-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i protokollit të mbledhjeve të verifikimit të titujve të pronësisë, u konstatua se në procesverbalet e mbajtura nuk janë regjistruar të plota problemet e trajtuara nga relatori i çështjes, diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre pro ose kundër në lidhje me çështjen që relatohet në komision. Prefekti, i cili thërret dhe drejton mbledhjen e KVVTP-së, nuk ka thirrur në mbledhje drejtues të institucioneve shtetërore dhe drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion mbi çështjet konkrete që shqyrtohen, për të shprehur mendimet e tyre mbi çështje të caktuara, veprim në papajtueshmëri me germën a, b, pika 6, kreu III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

9.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në të ardhmen, në procesverbalin e mbledhjeve të regjistroj problemet e trajtuar nga relatori i çështjes, diskutimet e secilit anëtar të komisionit, mendimin pro ose kundër të tij. Prefekti, bazuar në problematikën e secilës çështje që shqyrtohet, të kërkojë në mbledhjen e komisionit, pjesëmarrjen e drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion mbi çështjen që do të shqyrtohet. Për arsye të rëndësisë së çështjes, mendimi pro ose kundër i secilit anëtar të komisionit, për të gjitha çështjet që shqyrtohen e merret vendim për vlefshmërinë e titujve të pronësisë, përveçse shkruhet në protokoll, të hartohet e nënshkruhet në dokument më vete nga secili anëtar i komisionit e të bëhet pjesë e dosjes.

Menjëherë

10-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri me datë 30.06.2017, në zonat e ish NB-ve dhe zonat me përparësi turizmi, edhe pse ka hartuar plane pune dhe ka realizuar korrespondence shkresore me institucione si ZRPP Durrës, Këshilli i Qarkut, ISSH, Bashkisë Sukth, etj., praktikisht nuk ka mundur të realizojë asnjë kontroll të drejtpërdrejtë me nismën e vet, mbi veprimtarinë dhe veprimet e kryera nga ish-komisionet e tokës, në procesin e ndarjes së tokës, në kundërshtim me nenin 7, pika 2, germa b,

të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

10.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, nën mbikëqyrjen e Prefektit të Qarkut Durrës, të marrë masa për hartimin e një plani pune të veçantë dhe fillimin e kontrolleve konkrete, për verifikimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmi. Në rastet e pengesave të pajustificuara që krijohen nga institucione të tjera që kanë detyrimin të bashkëveprojnë për këtë qëllim, nga Komisioni dhe Prefekti të ndiqen të gjitha procedurat ligjore, deri në ankimim në organet gjyqësore, për pengesë në kryerjen e detyrës, në mënyrë që procesi i verifikimit të titujve të pronësisë nga Komisioni Vendor të ketë vazhdimësi dhe të realizohet brenda afateve ligjore.

Menjëherë

11-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në 4 raste, pas daljes së vendimit të Gjykatës për kthimin e sipërfaqes 51,000 m² nga përdorues të paligjshëm në pronësi të shtetit, nuk ka evidentuar procesin e lirimimit konkret të kësaj sipërfaqe (nëpërmjet ZRPP), si dhe nuk ka bërë dorëzimin e saj me procesverbal në Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Durrës, me qëllim që ti kthehet njësisë vendore, në juridiksion të së cilës ndodhet toka. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4, “Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë”, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

11.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në bashkëpunim me ZRPP, për tokën e përfituar në kundërshtim me ligjin nga z. **Xh.P.** nëpërmjet AMTP nr. 174/1 datë 14.09.1995, sipërfaqe 4,000 m², z. **E. K.** nëpërmjet AMTP datë 20.06.1996, sipërfaqe 6,000 m², z. **Z.G.** nëpërmjet AMTP 220 datë 11.02.1993, sipërfaqe 30,000 m², z. **N.Gj.** nëpërmjet AMTP 224 datë 11.02.1993 dhe AMTP nr. 221, datë 11.02.1993, sipërfaqe 11,000 m² të sigurojë lirimim e saj nga personat e mësipërm, të hartoj procesverbalin përkatës në përmbajtje të të cilit të pasqyrohet vendndodhja, numri kadastral i ngastrës, sipërfaqja në metër katror, e shoqëruar me planimetri. Ky procesverbal ti dorëzohet Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Durrës.

Menjëherë

12-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua performancë e ulët e punës së KVVTP-së, pasi nuk ka përfunduar shqyrtimin e mbi 50 % të kërkesave të ardhura për periudhën 2015-2017. Kështu nga 256 kërkesa gjithsej janë shqyrtuar dhe marrë vendime për 77 prej tyre dhe nuk është përfunduar ende shqyrtimi për 179 kërkesa, në kundërshtim me nenin nr. 12 të vendimit nr. 1, datë 27.03.2009 të Komisionit Qeveritar të Tokës, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë”.

12.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durrës, krahas shqyrtimit të kërkesave të ardhura rishtas, të marrë masa për shqyrtimin e 179 kërkesave të prapambetura të periudhës janar 2015-qershor 2017, të ardhura nga subjektet private dhe institucionet shtetërore.

Menjëherë

13-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor, të gjitha kërkesat për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP për periudhën 2015-2017 i ka shqyrtuar jashtë afateve ligjore, por veçanërisht në një rast marrja e vendimit është tej zgjatur me 3 vjet, pa shkaqe objektive. Konkretisht për

ankesën e ardhur nga DAMT e KQ Durrës datë 21.02.2013, për verifikimin ligjor të AMTP-së nr. 247 datë 28.11.1998, në emër të z.**H.H.** me sipërfaqe 5,000 m², nga Komisioni Vendor, vendimi me nr.32 për shfuqizimin e plotë të AMTP është marrë në datën 26.4.2017, ndërkohë që fakti se z. **H.H.** nuk ka qenë subjekt i ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” ka qenë i njohur qysh datë 02.10.2014, më shkresën nr. 232/3 të komunës Katund i Ri. Për rrjedhojë, pas datës 02.10.2014, zgjatja e marrjes së vendimit është e pa justifikuar ligjërisht, në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

13.1-Rekomandim: Prefekti i Qarkut Durrës, të nxjerrë përgjegjësitë për te zgjatjet e pajustificuara të shqyrtimit të kërkesës datë 21.02.2013 dhe marrjen e vendimit nr. 32, datë 26.4.2017 “për shfuqizimin e plotë të AMTP të **H.H.**” me 3 vjet vonesë. Në të ardhmen të mbikëqyrë Komisionin Vendor dhe të kërkojë prej tij zbatimin e afateve ligjore në shqyrtimin e kërkesave.

Menjëherë

14-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në 62 raste, në të cilat ka konstatuar shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, rezulton se ndaj anëtarëve të komisioneve të ndarjes së tokës të cilët kanë tejkualuar dhe shkelur kompetencat ligjore, nuk ka bërë kallëzim penal menjëherë pas marrjes së vendimit, por këto kallëzime i ka kryer të gjitha në 6-mujorin e parë të vitit 2017, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

14.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë dhe Prefekti i Qarkut Durrës, kur konstatojnë shkelje ndaj anëtarëve të komisioneve të ndarjes së tokës të cilët kanë tejkualuar dhe shkelur kompetencat ligjore, të bëjë ndaj tyre kallëzim penal të menjëhershëm.

Menjëherë

15-Gjetje nga auditimi: Në 70 raste, gjatë vitit 2013, në trajtimin e AMTP të familjeve të rrethit Kukës që përfitojnë tokë bujqësore në rrethin e Durrësit për shkak të përmytjes së tokës nga ndërtimi i HEC-eve, Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë ka shkelur procedurën dhe tejkualuar kompetencat, duke zbritur vet sipërfaqen 300 m² truall që ka secila AMTP, kompetencë që e ka vetëm gjykata. Ky tejkalim i kompetencave, përveç se nuk jep siguri dhe besueshmëri të qytetarët dhe institucionet, prish rrjedhën ligjore të trajtimit të çështjes, pasi ka shmangur kryerjen e kallëzimit penal për komisionin e ndarjes së tokës, veprim në kundërshtim me nenin 3, pika c, nenin 10, nenin 15 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

15.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, në rastet kur aktet e marrjes së tokës në pronësi kanë sipërfaqe toke jashtë kategorisë së tokës bujqësore, të marrë vendim për pavlefshmëri të pjesshme të aktit dhe për sipërfaqen e tokës jo bujqësore ti drejtohet Gjykatës për kthimin e saj në pronësi të shtetit.

Menjëherë

16-Gjetje nga auditimi: Struktura e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, pasi nuk ka në përbërje të saj specialist të profilit agronomë, inxhinierë gjeodet ose topografë, e cila ka ndikuar negativisht në shqyrtimin me kompetencë të çështjeve të titujve të pronësisë, si dhe është në kundërshtim me pikën 2 kreut III të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008, “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar.

16.1-Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Durrës të marrë masa për plotësimin e strukturës së

Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë me specialistë agronom, inxhinier gjeodet ose topograf.

Menjëherë

17-Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2013-2017, si rezultat i moszbatimit nga institucioni të procedurave ligjore për largimin e punonjësve nga puna, në 5 raste, u konstatua një efekt negativ financiar në buxhet në vlerën 3,051,564 leke, nga e cila vlera 1,245,551 lekë likuiduar (për 3 raste), ndërsa vlera 1,806,013 leke (për 2 raste) pritet të jap efekt negativ në periudhën në vazhdim. Efektet financiare të mësipërme, të cilat janë të mundura të eliminohen nga institucioni, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore përpara largimit të punonjësit nga puna, kanë impakt negativ në fondet publike të institucionit.

Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë analizuar vendimet gjyqësore, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

17.1-Rekomandim: Në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, nga institucioni të zbatohen të gjitha procedurat ligjore të largimit, me qëllim shmangien e efekteve negative në buxhet. Nga titullari, përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore, të analizohen këto vendime, të nxirren përgjegjësitë administrative, duke përcaktuar shkakun e ndodhjes së tyre, si dhe akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Menjëherë

18-Gjetje nga auditimi: Për periudhën janar 2013-qershor 2017 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 9 punonjës, të cilët përpara largimit nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal, përfshirë këtu dosjet shkresore, dokumentacionin elektronik, etj, veprime të cilat rrëzikojnë ruajtjen e vazhdimësisë së të dhënave të sektorit përkatës nga njëri specialist tek tjetri dhe krijimin e vështirësive reale për punonjësit e rinj. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13; VKM nr. 360, datë 14.07.2000 ”Për lirimin nga shërbimi civil”, pikat 19, 20 dhe 21 ”Dorëzimi i detyrës”; VKM nr. 171, datë 26.03.2014 ”Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, pika 50; -Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 25 “ Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit”, pika 3.

18.1-Rekomandim: Në rastin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, nga institucioni të kërkohet që punonjësi përpara largimit të bëjë dorëzimin e aktiveve që ka në inventar, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”.

Menjëherë

19-Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2014-2015 nga sektori i Policisë së Zjarrfikëseve (PMNZSH) janë vendosur 29 gjoba me një vlerë totale prej 190,000 leke, nga të cilat 7 gjoba nuk janë arkëtuar, duke krijuar të ardhur të munguar në vlerën 54,000 lekë. Gjithashtu 2 nga këto gjoba në vlerën 30,000 lekë nuk janë kontabilizuar nga zyra e financës së Sektorit të Zjarrfikëseve dhe Prefekturës, duke humbur gjurmën e tyre në kontabilitet, në kundërshtim me kërkesat e nenin 7, të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

19.1-Rekomandim: Nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, të merren masa për arkëtimin e 7 gjobave në vlerën 54,000 lekë dhe të kryhet kontabilizimi i 2 gjobave në vlerën 30,000 lekë, mbi bazën e procesverbaleve të mbajtura, duke u bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet.

Menjëherë

20-Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, i cili ka si qëllim përcaktimin e rregullave të shkruara të funksionimit të institucionit. Nuk është hartuar regjistri i riskut nga asnjë sektor e drejtori, duke mos u njohur dhe menaxhuar rrisqet që rrëzikojnë realizimin e objektivave. Nuk është hartuar rregullore e kodit të etikës, arkivës, gjurma e auditimit, si dhe nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik. Nga Titullari nuk është analizuar për asnjë vit funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, duke mos përcaktuar mangësitë që ka dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e gjendjes. Në këtë mënyrë nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në kundërshtim me nenet 8, 16, 22, 23, 24 të këtij ligji.

20.1-Rekomandim: Nga Titullari i institucionit, të ngrihet një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me rregulla të shkruara për secilin sektor dhe drejtori. Të hartohet rregullorja e kodit të etikës së institucionit, rregullorja e arkivës, regjistri i riskut, si dhe për proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion të hartohet gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës. Të monitorohet nga titullari sistemi i kontrollit të brendshëm, duke bërë përmirësimet e nevojshme në vazhdimësi.

Menjëherë

21-Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, nuk ka bërë ende regjistrimin në ZRPP Krujë të ambienteve të N/Prefektit të Rrethit Krujë dhe Stacionit Zjarrfikës Krujë, për arsye se të dhënat në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar me VKM nr.1691, datë 10.10.2007, nuk përputhen me plan rievimet faktike. Sipas VKM 1691 datë 10.10.2007 zyrat e N/Prefektit Krujë kanë sipërfaqe 74.8 m² dhe Stacioni Zjarrfikës ka sipërfaqe trualli 483 m², mbi të cilën sipërfaqe ndërtimi 225 m². Sipas plan rievimet faktike, zyrat e N/Prefektit Krujë kanë sipërfaqe 132 m² (57.2 më shumë) dhe Stacioni Zjarrfikës ka sipërfaqe trualli 728 m² (245 më shumë) dhe sipërfaqe ndërtese 225 m².

Për këtë arsye dy asetet e mësipërme nuk janë të regjistruara në kontabilitetin e institucionit, duke bërë që pasqyrat financiare për këtë llogari, të mos japin gjendjen e saktë të pasurisë së institucionit, në kundërshtim me kërkesat e nenin 7, të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

21.1-Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, të kryej të gjitha veprimet e duhura për regjistrimin në ZRPP Durrës, të truallit dhe godinës së N/Prefektit të rrethit Krujë dhe pas këtyre veprimeve, të bëhet regjistrimi i asetit në kontabilitet.

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1-Gjetje nga auditimi: Detyrimet e institucionit të Prefektit të Qarkut Durrës për shpenzimet gjyqësore për periudhën 2008-2017 kapin vlerën 20 milion lekë, nga të cilat 16 milion lekë janë likuiduar, ndërsa 4 milion lekë do të kenë ndikimin e tyre negativ në buxhetin e periudhës në vazhdim. Peshën kryesore e zë vlera 11,386,225 lekë, “Vendim i Gjykatës për dëmshpërblim deri në momentin e kthimit në punë”, për tre punonjës të policisë së zjarrfikëseve, të cilët nuk janë rimarrë në punë nga institucioni për një kohë të gjatë, dy prej të cilëve për periudhën 2008-2014, pas së cilës punonjësit kanë dalë në pension, ndërsa një punonjës për periudhën 2008-2016, pas së cilës është rimarrë në punë. Nga titullari nuk janë analizuar vendimet gjyqësore dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të

udhëzimin nr.2, datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7/2-Auditim mbi funksionimin e KVVTP për periudhën 2015-2017, faqe 64-86 të Projektit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1-Rekomandim: Nga Prefekti i Qarkut Durrës, përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore, të analizohen këto vendime, të nxirren përgjegjësitë administrative, duke përcaktuar shkaqet e ndodhjes së tyre. Në rastet kur vendimet janë për rikthim në punë, titullari të zbatojë vendimin e gjykatës, me qëllim shmangien e shpenzimeve me efekt negativ në buxhet.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe *nenit 9 të kontratës individuale të punës, datë 17.02.2014*, i rekomandojë Prefektit të Qarkut Durrës, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2017, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, nga “**Vërejtje deri në zgjidhje të kontratës së punës**” për 5 punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. E.Ç. me detyrë drejtor i Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, emëruar me urdhrin nr. 10, datë 17.02.2014, **për shkeljet e mëposhtme:**

- Për mos përfundimin e shqyrtimit të 190 kërkesave (11 për vitin 2014 dhe 179 për periudhën janar 2015-qershor 2017), në kundërshtim me nenin 9/3 dhe 14 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e KVVTP” .

- Për shqyrtimin jashtë afatit ligjor 3 mujor, të 87 kërkesave për periudhën 2014-2017 (10 për vitin 2014 dhe 77 për periudhën 2015-2017), në kundërshtim me nenin 12 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e KVVTP” .

- Për mos marrjen e masave të plota, me pasojë mos realizimin e kontrolleve të drejtpërdrejta me nismën e vet, mbi veprimtarinë dhe veprimet e kryera nga ish-komisionet e tokës, në procesin e ndarjes së tokës, për periudhën mars 2014- qershor 2017, në kundërshtim me nenin 7, pika 2, germa b, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

-Për mos evidentim të procesit të lirimit të tokës bujqësore dhe mosdorëzimit të saj në DAMT Durrës për sipërfaqen 51,000 m2 tokë bujqësore, e cila me vendim gjykate është hequr nga përdoruesit e paligjshëm dhe është kthyer në pronësi të shtetit (10,000 m2 në vendimet e vitit 2014 dhe 41,000 m2 në vendimet e periudhës 2015-2017).

- Për mos zbatim të nenit 15 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, pasi në 8 raste gjatë vitit 2014, 26 raste në vitin 2015, 28 raste në vitin 2016 nuk është kryer kallëzim penal menjëherë pas shqyrtimit të dosjes, për komisionin e ndarjes së tokës, të cilët kanë shkelur dispozitat ligjore në fuqi, por këto kallzime janë kryer të gjitha në vitin 2017.

- Në dy raste ka vendosur mos shqyrtimin e AMTP, duke mos siguruar informacion të plotë për çështjen.

- Për mos kryerje të hetimit të plotë administrativ në dy raste: në shqyrtimin e kërkesës së vëllezërve **Sh.** për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 280, date 10.7.2006 dhe kërkesës së z. **A.S.** për verifikimin e AMTP nr. 245, 245/1 dhe 245/2.

- Për shqyrtimin në një rast të vlefshmërisë ligjore të AMTP (nr. 58 datë 23.07.1992 të z.**Sh.F.**, e cila nuk është dokument origjinal, por fotokopje.
- 2. **Z.F.G.** specialist i KVVTP për periudhën 11.11.2014-30.06.2017, (emëruar me urdhrin nr. 148, datë 11.11.2014).
- 3. **Z.V.Xh.** specialist i KVVTP për periudhën 10.02.2014-30.06.2017, (emëruar me urdhrin nr. 9, datë 10.02.2014), *për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:*
 - Për performancë të ulët të punës për arsye të numrit të vogël të kërkesave të shqyrtuara për periudhën 2015-2017.
 - Për mos përfundimin e shqyrtimit të kërkesave të ardhura për vlefshmërinë ligjore të titujve të pronësisë, për periudhën janar 2015-qershor 2017, sipas ndarjes së bërë nga Drejtori i KV, në kundërshtim me nenin 9/3 dhe 14 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e KVVTP” .
 - Për shqyrtimin jashtë afatit ligjor 3 mujor të kërkesave të trajtuara prej tyre, sipas ndarjes së bërë nga Drejtori i KV, për periudhën janar 2015-qershor 2017, në kundërshtim me nenin 12 e 14 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e KVVTP”.
 - Për mos kryerje të hetimit të plotë administrativ në dy raste: në shqyrtimin e kërkesës së vëllezërve Shehu për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 280, date 10.7.2006 dhe kërkesës së z. **A.S.** për verifikimin e AMTP nr. 245, 245/1 dhe 245/2.
 - Për shqyrtimin në një rast të vlefshmërisë ligjore të AMTP (nr. 58 datë 23.07.1992 të z.**Sh.F.** e cila nuk është dokument origjinal, por fotokopje, në kundërshtim me UKM nr.2, datë 13.01.2010.
 - për mos inventarizimin e plotë të 9 dosjeve, në papajtueshmëri me germën dh nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.
 - Për mos zbatim të nenit 15 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, pasi për periudhën 2014-2016, nuk është kryer kallëzim penal menjëherë pas shqyrtimit të dosjes, për komisionin e ndarjes së tokës të cilët kanë shkelur dispozitat ligjore në fuqi, por këto kallëzime janë kryer të gjitha në vitin 2017 (Për vitin 2014 kjo shkelje është në 5 raste për z.**V.Xh.**
 - Për mos marrjen e masave të plota për zbatimin e urdhrin nr.46, datë 01.04.2014 “Për kontrollin e vlefshmërisë ligjore të AMTP të ndara në fshatin Hamallaj dhe Rrushkull” dhe urdhrin nr.57 datë 14.05.2014 të Prefektit të Qarkut Durrës “Për verifikimin e AMTP në ish ndërmarrjet bujqësore Rinia dhe Bishtë Kamëz (zonat me përparësi turizi dhe ish NB), në kundërshtim me nenin 7, pika 2, germa b, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. (Për vitin 2014 kjo shkelje është për z.**V.Xh.**)
- 4. Znj. **I.A.**, me detyrë specialist në KVVTP, për periudhën 06.06.2016-30.06.2017, emëruar me urdhrin nr. 24, datë 06.06.2016.
- 5. Z. **N.M.**, me detyrë specialist në KVVTP, për periudhën 06.06.2016-30.06.2017, emëruar me urdhrin nr. 25, datë 06.06.2016, *për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:*
 - Për performancë të ulët të punës për arsye të numrit të vogël të kërkesave të shqyrtuara për periudhën korrik 2016-qershor 2017.
 - Për shqyrtimin jashtë afatit ligjor 3 mujor, të kërkesave për shqyrtimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, në dy raste nga z. **N.M.** dhe 5 raste nga znj.**I.A.** në kundërshtim me nenin 12 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e KVVTP.

Shënim: Për punonjësit e larguar.

Për 11 ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla,

pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

1. Znj.**L.I.** me detyrë ish drejtor i Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësis për periudhën 01.01.2013-31.12.2013, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr.141, datë 31.12.2013.
2. Z. **E.P.** me detyrë ish specialist në Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, për periudhën 01.01.2013-03.03.2014, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr.21, datë 03.03.2014.
3. Znj.**M M.** me detyrë ish specialiste e Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësis për periudhën 01.01.2013-31.12.2013, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr.142, datë 31.12.2013.
4. Znj. **A.M.** me detyrë ish specialiste e Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësis për periudhën 01.01.2013-23.03.2016, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr.12, datë 23.03.2016.
5. Znj. **V.Rr.** me detyrë ish specialiste e Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësis për periudhën 01.01.2013-23.03.2016, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr.13, datë 23.03.2016.
6. Z. **K.S.** me detyrë ish specialist në Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, për periudhën 24.02.2014-03.11.2014, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 03.11.2014.
7. Z. **E.B.** me detyrë shefi i sektorit të PMNZSH për periudhën 01.01.2013-16.04.2014 ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 16.04.2014.
8. Z. **M.M.** me detyrë ish shefi i zyrës së parandalimit në sektorin e PMNZSH, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 31.12.2015.
9. Z. **G.K.** me detyrë ish inspektorët e zyrës së parandalimit në sektorin e PMNZSH ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 09.05.2014.
10. Z. **B. K.** me detyrë ish inspektorët e zyrës së parandalimit në sektorin e PMNZSH, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 31.12.2015
11. Znj. **E.K** me detyrë specialiste e financës së sektorit të PMNZSH, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 31.12.2015.

D. TË TJERA

Auditimi i kryer vlerësohet dobët nga Kryetari i KLSH-së dhe kjo periudhë e audituar do të riuauditohet në një kohë të dytë, ose në auditimin e radhës.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR